

Z. Njehonca  
Z. Mici

14.12.2021



4867

08.12.21

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA PËR EVROPËN DHE PUNËT E JASHTME

Nr. Prot. 17585

Tiranë, më 07.12.2021

Lënda: Dërgohet marrëveshje për kompetencë

**MINISTRISË SË SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE**

**Tiranë**

Bashkëlidhur ju përcjellim për kompetencë kopje të “Marrëveshjes për bashkëpunimit ndërmjet Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale të Republikës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve të Republikës së Kosovës”, nënshkruar në Elbasan, më 26 nëntor 2021.

Në zbatim të nenit 8 të marrëveshjes së sipërcituar, data e hyrjes në fuqi është data e nënshkrimit të saj nga palët.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin.

**SEKRETARI I PËRGJITHSHËM**



**Armand Skapi**

**MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI**

**NDËRMJET**

**MINISTRISË SË SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE TË REPUBLIKËS SË  
SHQIPËRISË**

**DHE**

**MINISTRISË SË FINANCAVE, PUNËS DHE TRANSFEREVE TË REPUBLIKËS SË  
KOSOVËS**

**Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale e Republikës së Shqipërisë, këtu dhe më poshtë referuar (MSHMS)**

**dhe**

**Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve e Republikës së Kosovës, këtu dhe më poshtë referuar si (MFPT)**

**Në vijim referuar si “Palët”,**

**Kanë rënë dakord si vijon:**

### **Neni 1 Objekti**

Objekti i kësaj Marrëveshjeje është zhvillimi dhe forcimi i bashkëpunimit në mes të dy vendeve në fushën e të drejtave dhe mbrojtjes së fëmijëve, nisur nga parimi për mbrojtjen e interesit më të lartë të fëmijës, në zbatim të kuadrit ligjor, politikave dhe programeve sociale për mbrojtjen e fëmijëve.

### **Neni 2 Qëllimi**

Qëllimi i kësaj Marrëveshjeje është përcaktimi i rregullave të bashkëpunimit në mes të shteteve palë dhe koordinimit në mes të institucioneve për mbrojtjen dhe ofrimin e shërbimeve për fëmijë.

1. Marrëveshja synon përcaktimin e rregullave të bashkëpunimit të shteteve palë për të siguruar:

- a) mbrojtjen e fëmijëve pa kujdes prindëror që janë lindur dhe braktisur nga prindërit brenda territorit të të dy vendeve, përmes koordinimit në mënyrë të përbashkët të veprimeve dhe procedurave institucionale.
- b) riatdhesimin e fëmijëve të pashoqëruar, përfshirë fëmijët të deklaruar të humbur, që ndodhen në territorin e të dy vendeve.
- c) lehtësimin për realizimin e kontaktimit të fëmijëve me prindër të ndarë apo të shkurorëzuar që ndodhen në territorin e dy vendeve.

2. Bashkimin e fëmijës me familjen biologjike, apo ofrimin e mbrojtjes institucionale, si dhe riatdhesimit në shtetin origjinë.

**Neni 3**  
**Pikat e kontaktit**

1. Pikë kontakti për Palën Shqiptare do të jenë: personi përgjegjës i cili mbulon çështjet që kanë të bëjnë me të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës pranë Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale; dhe Kryetari i Agjencisë Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës.
2. Pikë kontakti për Palën Kosovare do të jenë: personi përgjegjës i cili mbulon çështjet që kanë të bëjnë me të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës pranë Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve / Departamenti i Politikave Sociale dhe Familjes.

**Neni 4**  
**Të drejtat dhe detyrimet e palëve**

**A) Të drejtat dhe detyrimet e Palës Shqiptare:**

1. Koordinon dhe monitoron zbatimin e kësaj Marrëveshjeje, duke organizuar dhe drejtuar takime të ndryshme dypalëshe për diskutimin e ecurisë dhe problematikave të identifikuara gjatë zbatimit, me qëllim të realizimit të detyrimeve të përcaktuara në Marrëveshje;
2. Siguron funksionimin e sistemit të integruar në mbrojtjen e të drejtave dhe mbrojtjes së fëmijëve, përmes koordinimit dhe bashkërendimit të punës me institucionet përgjegjëse në nivel qendror dhe vendor;
3. Siguron kryerjen e të gjitha procedurave duke respektuar legjislacionin në fuqi, përmes Agjencisë për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës dhe Njësive të Mbrojtjes së Fëmijëve;
4. Koordinon me strukturat nën varësinë e MSHMS-së ofrimin e shërbimeve sociale, rehabilituese, riintegruese dhe ligjore për fëmijët në nevojë për mbrojtje, të cilët kanë nevojë për shërbime, ndërhyrje apo masa mbrojtjeje;
5. Garanton zbatimin e interesit më të lartë të fëmijës, duke i dhënë mundësinë për të siguruar kthimin më të lehtë, të shpejtë dhe të përshtatshëm për të, në përputhje me moshën dhe mundësinë për të përballuar pa asnjë vështirësi kthimin, duke garantuar dinjitetin, nderin dhe personalitetin e fëmijës;
6. Organizon takime për shkëmbimin e përvojave dhe informacioneve nga të dy vendet lidhur me menaxhimin dhe trajtimin e rasteve të fëmijëve në nevojë për mbrojtje;

7. Zhvillon trajnime për rritjen e kapaciteteve të punonjësve, të cilët janë të përfshirë në trajtimin e këtij grupi fëmijësh.

B) Të drejtat dhe detyrimet e Palës Kosovare:

1. Koordinon dhe monitoron zbatimin e kësaj Marrëveshjeje, duke organizuar dhe drejtuar takime të ndryshme dypalëshe për diskutimin e ecursisë dhe problematikave të identifikuara gjatë zbatimit, me qëllim të realizimit të të gjitha detyrave dhe përgjegjësive bazuar në këtë Marrëveshje.

2. Siguron funksionimin e sistemit të integruar në mbrojtjen e të drejtave dhe mbrojtjes së fëmijëve, përmes koordinimit dhe bashkërendimit të punës me institucionet përgjegjëse në nivel qendror dhe lokal;

3. Siguron kryerjen e të gjitha procedurave duke respektuar legjislacionin në fuqi, përmes Departamentit përkatës në MFPT dhe Qendrave për Punë Sociale.

4. Koordinon me strukturat e nivelit qendror (MFPT) dhe nivelit lokal (komunat) për ofrimin e shërbimeve sociale, rehabilituese, riintegruese dhe ligjore për fëmijët në nevojë për mbrojtje, të cilët kanë nevoja për shërbime, ndërhyrje apo masa mbrojtjeje;

5. Garanton zbatimin e interesit më të lartë të fëmijës, duke i dhënë mundësinë për të siguruar kthim më të lehtë, të shpejtë dhe të përshtatshëm për të, në përputhje me moshën dhe mundësinë për të përballuar pa asnjë vështirësi kthimin, duke garantuar dinjitetin, nderin dhe personalitetin e fëmijës;

6. Organizon takime për shkëmbimin e përvojave dhe informacioneve nga të dy vendet lidhur me menaxhimin dhe trajtimin e rasteve të fëmijëve në nevojë për mbrojtje;

7. Zhvillon trajnime për rritjen e kapaciteteve të punonjësve, të cilët janë të përfshirë në trajtimin e këtij grupi fëmijësh.

#### **Neni 5 Zbatimi**

1. Palët do të organizojnë takime çdo vit, për vlerësimin e ecursisë dhe ndërhyrjeve të objektit të kësaj Marrëveshjeje, sfidat e hasura, nevojat për përmirësime dhe për të dhënë zgjidhjen me synim zbatimin me sukses të prioriteteve. Koha e takimit përcaktohet në mirëkuptim mes Palëve.

2. Palët nuk kanë detyrime financiare kundrejt njëra – tjetrës, gjatë zbatimit të kësaj Marrëveshjeje.

**Neni 6**  
**Zgjidhja e mosmarrëveshjeve**

Të gjitha mosmarrëveshjet që mund të lindin nga zbatimi i kësaj Marrëveshjeje do të zgjidhen në rrugë miqësore ndërmjet Palëve, nëpërmjet kanaleve diplomatike.

**Neni 7**  
**Ndryshimi dhe përfundimi i Marrëveshjes**

1. Kjo Marrëveshje mund të ndryshohet në çdo kohë, me pëlqimin e ndërsjellë me shkrim të Palëve. Këto ndryshime do të hyjnë në fuqi sipas procedurës së përcaktuar në nenin 8 të saj.
2. Marrëveshja mund të denoncohet me shkrim në çdo kohë nga secila prej Palëve dhe do të pushojë së prodhuari efektet e saj tre muaj pas marrjes së njoftimit të denoncimit, duke argumentuar dhe arsyet e këtij denoncimi.

**Neni 8**  
**Hyrja në fuqi dhe kohëzgjatja**

Kjo Marrëveshje hyn në fuqi ditën e nënshkrimit të saj.


Nënshkruar në Elbasan, më 26 nëntor 2021, në dy kopje në gjuhën shqipe, protokollohet nga secila palë dhe të dyja kopjet janë njësoj të vlefshme.

**PËR MINISTRINË E SHËNDETËSISË  
DHE MBROJTJES SOCIALE TË  
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

Znj. Ogerta MANASTIRLIU



**PËR MINISTRINË E FINANCAVE,  
PUNËS DHE TRANSFEREVE TË  
REPUBLIKËS SË KOSOVËS**

  
Z. Hekuran MURATI